



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 2669/2 prot.

Tiranë, më 28. 6 .2022

**VENDIM**

**Nr. 26, datë 28.6.2022**

**PËR**

**NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN “PËR ORGANIZIMIN E  
ADMINISTRATËS SË KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT”**

Në zbatim të VKM –së nr. 518, datë 6.10.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore”, si dhe të rregullores “Për veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, miratuar me vendimin nr. 2, datë 19.7.2017, përmes votimit, në mbledhjen e datës 28.6.2022, Komisioni, me unanimitet,

**V E N D O S I:**

1. Pika 2 e nenit 24 ndryshon dhe bëhet:
  2. “Orari ditor i punës fillon çdo ditë, nga e hëna në të enjte, në orën 8:30 dhe përfundon në orën 17:00. Orari i ditës së premte është 8:30 – 14:30.”
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Zyra e Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 korrik 2022.

